



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/02 / 11/

Datë: 01.02.2022

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040 neni 52 , Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.09.2010) neni 36 dhe 37, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

- I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Politikë dhe Financa si komitet i përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.
- II. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale , (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52.1, Komiteti për Politikë dhe Financa Kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit.
- III. Komiteti për Politikë dhe Financa do të ketë përbërjen si në vijim:
 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, subjekti politik LDK
 2. Ermelinda Llojluni - anëtare, subjekti politik LDK
 3. Dervish Bajraktari - anëtar, subjekti politik AAK
 4. Rajmonda Krasniqi - anëtare, subjekti politik AAK
 5. Xhemë Tofaj - anëtar, subjekti politik LVV
- IV. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik,. Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe cdo ndryshim të buxhetit për vitin fiskal, si dhe për marrjen raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa ;
3. Drejtoria për Ekonomi Buxhet dhe Financa;
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi



Adresa:

Tel.: +383 (0) 44 270 947

<http://rks-gov.net/junik>